



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/ Nr. 294/2025

Datë: 30 prill 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.25 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 12 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve në takimin e mbajtur me datë 30 prill 2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Themelohet Paneli Hetimor i Këshillit Prokurorial të Kosovës për hetimin e rastit disiplinor AD.Nr.06/2025 në Prokurorinë Themelore në Pejë, në këtë përbërje:
 - 1.1 Z. Petrit Kryeziu, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren - Kryesues;
 - 1.2 Z. Shahadin Destani, Prokuror në Prokurorinë Speciale - Anëtar;
 - 1.3 Znj. Ajtene Zoni, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë - Anëtare.
2. Paneli Hetimor do të ketë anëtarët rezervë në këtë përbërje:
 - 2.1 Znj. Arbëresha Shala, Prokurore në Prokurorinë Speciale;
 - 2.2 Z. Rafet Halimi, Prokuror në Prokurorinë Speciale.
3. Obligohen anëtarët e Panelit Hetimor nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t'i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet :

- Anëtarëve të Panelit Hetimor;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së;